



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesu dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.383/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Lutfi Zharku kandidat për deputet nga koalicioni LDK-AKR, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Pranohet** si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Lutfi Zharku nga koalicioni LDK-AKR,
- II. **Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni LDK-AKR në Vendvotimin 2510D/04R
- III. **Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.
- IV. **Mirlindë Bajrami** me nr. të letërnjoftimit [redacted] në cilësinë e Kryesueses të Vendvotimit 2510D/04R, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 30.06.2017 në ora 12:05, nga Lutfi Zharku kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se në Vendvotimin nr.2510D/04R është bërë një gabim në formularin e rezultateve ku votat e kandidatit me nr.41 e Lutfi Zharku I janë shënuar kandidatit me numër 40, ky gabim ka ndikuar në rezultatin final dhe kërkon të rinumrohen votat në këtë vendvotim ose të përmisohet ky gabim.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 2510D/04R është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidati me nr.41, nga radhët e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Komuna e Prishtinës, ka vetëm një votë, në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i ankesës i posedon 49 vota të vlefshme.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkritazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit, për pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, sepse Kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par.10 të LZP-së, Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë, ka bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesës i është regjistruar vetëm një votë në FRK, ndonëse pas hetimeve të bëra nga paneli është vërtetuar se i njëjti i posedon 49 vota.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 383/2017 më datën 02.07.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.